



ANALIZË DHE KOMENTE NË PROJEKTLIGJIN PËR

ENERGJINË



ANALIZË DHE KOMENTE NË PROJEKTLIGJIN PËR ENERGJINË

Mars, 2024

Autorë: Dardan Abazi
Liron Gjocaj

Programi: Zhvillim i Qëndrueshëm

Publikuar: Mars, 2024



Zhvillimi i Qëndrueshëm
Sustainable Development

Instituti për Politika Zhvillimore – INDEP

Botim i Institutit për Politika Zhvillimore (INDEP). Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk guxon të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave apo të transmetohet, në asnjë formë apo mënyrë, pa pëlqim paraprak nga botuesi. Botimi mund të shpërndahet në formë elektronike, por vetëm në tërësi dhe vetëm për qëllime jokomerciale.



**Rockefeller
Brothers Fund**
Philanthropy for an Interdependent World

Ky punim është publikuar me mbështetjen e Fondit të Vëllezërve Rockefeller (RBF). Mendimet dhe pikëpamjet e autorëve nuk shprehin ose pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të RBF.

Përmbajtja

Hyrje dhe Komete të Përgjithshme.....	1
Komentet dhe rekomandimet specifike të INDEP	2
Përfundime dhe Rekomandime	12

Hyrje dhe Komente të Përgjithshme

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP), ka analizuar Projektligjin për Energjinë, i hartuar dhe publikuar për konsultim nga ana e Ministrisë së Ekonomisë së Republikës së Kosovës. Kjo analizë dhe këto komente janë rezultat i përkushtimit që Instituti INDEP ka për fuqizim të sektorit të energjisë dhe për rritje të dinamikës së tranzicionit të drejtë energjetik. Analiza e hartuar në kuadër të programit të INDEP për zhvillim të qëndrueshëm, synon që të identifikoj fushat ku projektligji ka nevojë për përmirësim dhe të ofroj një qasje konstruktive për përmirësimin e tij.

Marrë në tërësi, INDEP konsideron që Projektligji për Energji i plotëson kërkesat e direktivave evropiane për pakon e re të legjislacionit në fushën e energjisë dhe është një bazë e mirë për rregullimin ligjor të sektorit për vitet e ardhshme.

Gjatë analizës së projektligjit, INDEP ka vërejtur që Projektligji ka nevojë për specifikim të disa elementeve veçanërisht sa i takon konsumatorëve në nevojë, konfirmim ligjor të përkushtimit për dekarbonizim, ruajtjen të pavarësisë dhe rolit rregullator të ZRRE-së dhe definime më të qarta dhe specifikime sa i takon rolit të komunave, sistemeve të mbyllura të distribucionit etj.

Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP) thekson rëndësinë e angazhimit dhe konsultimit të gjerë me të gjithë palët e interesit në procesin e rishikimit dhe përmirësimit të Projektligjit për Energjinë. Në dokumentin e konsultimit, ne i bëjmë thirrje Qeverisë që të përfshij qëndrimet e ZRRE-së, KOSTT-it dhe akterëve të tjerë në mënyrë që publiku i gjerë të njihet me pikëpamjet e këtyre palëve. Përmes një qasjeje të tillë të hapur dhe gjithëpërfshirëse, INDEP beson se mund të kontribuohet në zhvillimin e një kuadri ligjor që nxit inovacionin, përmirëson eficiencën e energjisë, mbështet tranzicionin drejt burimeve të rinovueshme të energjisë, dhe përmbush nevojat e të gjithë qytetarëve të Kosovës, veçanërisht ato të konsumatorëve në nevojë.

Kosova ka adoptuar një strategji të re të energjisë që vendos shtetin në rrugën e dekarbonizimit. Për këtë, rëndësia e Projektligjit për Energjinë bëhet edhe më thelbësore. Ky ligj jo vetëm që shërben si shtyllë kyçe për të mbështetur realizimin e kësaj strategjie, por gjithashtu siguron një bazë ligjore për të inkurajuar investimet në teknologjitë e reja dhe të qëndrueshme energjetike. Përmes forcimit të kornizës ligjore për energjinë, Kosova mund të avancojë në zbatimin e angazhimeve ndërkombëtare për ndryshimet klimatike, të rrisë sigurinë e furnizimit me energji dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët e saj. Ky ligj dhe transpozimi i pakos së re të legjislacionit të Komunitetit të Energjisë është një hap shumë i rëndësishëm drejt një ekonomie më të gjelbër dhe më të qëndrueshme, dhe një pjesë shumë e rëndësishme e rrugëtimit të Kosovës drejt dekarbonizimit dhe përafrimit me standardet dhe praktikatat më të mira evropiane në fushën e energjisë. Prandaj, mundësia për ta bërë këtë Ligj më të mirë e më të zbatueshëm, nuk duhet humbur!

Në vazhdim, INDEP ka listuar komentet pas analizës nen-për-nen të Projektligjit. Në pjesën në vazhdim, do të paraqesim vërejtjet dhe rekomandimet specifike të INDEP në lidhje me këtë Projektligj.

Komentet dhe rekomandimet specifike të INDEP

Komenti 1. Neni 4 – Konsumatorët në nevojë, Paragrafi 2

“Ministria përgjegjëse për mirëqenie sociale njofton **brenda tetë (8) ditëve kalendarike** konsumatorët në nevojë, operatorin e sistemit të shpërndarjes dhe furnizuesit që furnizojnë konsumatorët në nevojë për përcaktimin e statusit ose ndryshimet në statusin e tillë, ose ndërprerjen e statusit të konsumatorit në nevojë.”

Është e paqartë pjesa ku theksohet afati kohor prej tetë (8) ditëve kalendarike. Të riformulohet fjalia në tërësi, ose të ofrohet një shpjegim më i detajuar rreth këtij afati kohor. Për më tepër, nuk është cekur se prej kur fillohet të numërohet periudha prej tetë (8) ditëve.

INDEP kërkon që ky paragraf të riformulohet, të integrohen më shumë detaje dhe informacione rreth afatit kohor prej tetë (8) ditësh. INDEP propozon që paragrafi të riformulohet në këtë mënyrë:

"Ministria përgjegjëse për mirëqenien sociale do të sigurojë që njoftimet në lidhje me përcaktimin, çdo ndryshim apo përfundimin e statusit të konsumatorëve në nevojë t'u lëshohen konsumatorëve të prekur, operatorit të sistemit të shpërndarjes dhe furnitorëve që u shërbejnë këtyre konsumatorëve. Ky njoftim duhet të ekzekutohet brenda tetë (8) ditëve kalendarike. Periudha prej tetë (8) ditësh fillon të llogaritet nga dita pas marrjes së vendimit zyrtar nga organi kompetent lidhur me statusin e konsumatorit.”

Komenti 2. Neni 4 – Konsumatorët në nevojë, Paragrafi 4

“Konsumatorët në nevojë **kanë të drejtë të furnizohen me sasi minimale të energjisë** dhe ose të subvencionohen për energjinë e konsumuar.”

INDEP propozon që të riformulohet kjo fjali, për shkak se një formulim i tillë është konfuz dhe mund të keqinterpretohet. Kjo për faktin se mund të interpretohet si kufizim i sasisë së energjisë elektrike që mund të shfrytëzohet nga konsumatorët në nevojë. Ne propozojmë që fjalia të riformulohet në këtë mënyrë:

“Konsumatorët në nevojë kanë të drejtë të furnizohen **së paku** me sasi minimale të energjisë dhe/ose të subvencionohen për energjinë e konsumuar”

Komenti 3. Neni 4 – Konsumatorët në nevojë, Paragrafi 6.5

“masat shtesë për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, duke përfshirë eficiencën e energjisë dhe masat sociale dhe ekonomike”

Të shtohet në këtë paragraf edhe zgjidhja e ngohjes. INDEP propozon që Paragrafi 6.5 të formulohet në këtë mënyrë:

“masat shtesë për mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë, duke përfshirë eficiencën e energjisë, **duke ofruar zgjidhje për ngrohje** dhe masat sociale dhe ekonomike”

Komenti 4. Neni 4 – Konsumatorët në nevojë

Ne propozojmë që të shtohet një paragraf i veçantë brenda këtij neni, i cili përcakton saktësisht kriteret të cilat e bëjnë një konsumator të energjisë elektrike pjesë të kategorisë së konsumatorëve në nevojë. INDEP propozon që një paragraf i tillë të formulohet si më poshtë:

"Kategoria e Konsumatorëve në nevojë do të përfshijë ata konsumatorë të energjisë elektrike, kushtet socio-ekonomike të cilëve kufizojnë mundësitë e tyre për të përballuar shërbimet bazë të energjisë elektrike. Kriteret për klasifikimin si konsumator në nevojë do të përfshijnë, familjet me nivel të hyrave nën 60% të të pagës mesatare në Republikën e Kosovës, familjet që marrin ndihmë sociale në kuadër të programeve të mirëqenies sociale të Republikës së Kosovës dhe personat me aftësi të kufizuara..”

Ky proces siguron që mbështetja të drejtohet drejt atyre që kanë më shumë nevojë, duke promovuar qasje të barabartë në shërbimet energjetike në të gjithë Republikën e Kosovës. INDEP konsideron që kriteri bazë për kualifikim si konsumatorë në nevojë duhet të përcaktohet me ligj, dhe jo me akt nënligjor.

Komenti 5. Neni 5 – Obligimi i shërbimit publik

INDEP propozon që tek Paragrafit 2, 3, 4, 5, 6, 7, 10 të Nenit 4 – Obligimi i shërbimit publik, të largohet Qeveria dhe vendimet e përmendura në këtë ligj të mirren vetëm nga Rregullatori, pra:

“Rregullatori ~~ose Qeveria~~, në varësi të fushave të tyre të përgjegjesisë, vendos obligimin e Shërbimit Publik ndaj ndërmarrjes së energjisë në pajtim me Ligjin përkatës për Energjinë Elektrike. Të drejtat dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga ky obligim përcaktohen në lejen përkatëse të ndërmarrjes së energjisë.”

“Rregullatori ~~ose Qeveria~~ mund t'i vendos një ndërmarrje të energjisë obligimin e shërbimit publik drejtpërdrejt në rastet e mëposhtme”

“Rregullatori ~~ose Qeveria~~, në bazë të një vlerësimi të mëparshëm, mund të vendosin drejtpërdrejt obligimin e shërbimit publik për një ndërmarrje të energjisë për qëllime të arritjes së objektivave që kanë të bëjnë me likuiditetin e tregut.”

“Kurdoherë që është e përshtatshme dhe e nevojshme, Rregullatori ~~ose Qeveria~~ mund të vendosin obligimin e shërbimit publik për një ndërmarrje të energjisë e cila është përzgjedhur me një proces konkurrues dhe transparent siç përcaktohet në Ligjin përkatës për Energjinë Elektrike lidhur me përzgjedhjen e Furnizuesit të Shërbimit Universal.”

“Shërbimi i ofruar në bazë të obligimit të shërbimit publik sigurohet në përputhje me afatet dhe kushtet e përcaktuara nga Rregullatori ~~ose Qeveria~~ në vendimin me

të cilin vendoset obligimi i shërbimit publik. Afatet dhe kushtet për ofrimin e obligimit të shërbimit publik përfshihen në lejen përkatëse të ndërmarrjes së energjisë.”

“Rregullatori ~~ose Qeveria~~ në vendimin me të cilin vendoset obligimi për shërbimin publik përcakton fushëveprimin dhe afatin kohor të obligimit të shërbimit publik, duke marrë parasysh se obligimi i vendosur i shërbimit publik kufizohet në kohë dhe nuk duhet të jetë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur objektivin e synuar të interesit të përgjithshëm ekonomik.”

“Rregullatori ~~ose Ministria, në emër të Qeverisë~~, pa vonesë do ta informojnë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë për vendimin nga paragrafi (3) i këtij neni, si dhe për ndikimet e mundshme e vendimit të tillë në funksionimin e tregun e energjisë.”

Vendimet e përbashkëta ndërmjet Rregullatorit dhe Qeverisë cenojnë pavarësinë e Rregullatorit, të drejtat e Rregullatorit dhe në formë direkte ndikojnë në punën e Rregullatorit.

Në kontekstin e rregullimit të sektorit të energjisë, roli i Rregullatorit është të jetë një autoritet i pavarur që garanton zbatimin e praktikave më të mira dhe standardet për një treg të drejtë dhe të qëndrueshëm energjetik. Propozimi i INDEP për të koncentruar vendimmarrjen lidhur me obligimin e shërbimit publik ekskluzivisht tek Rregullatori ndërlidhet me nevojën për një qasje më të qartë dhe më të drejtpërdrejtë në menaxhimin e kësaj çështjeje të ndjeshme. Pavarësia e Rregullatorit është e domosdoshme për ta ruajtur atë nga ndikimet politike, duke siguruar që vendimet merren në bazë të analizës teknike dhe objektive në përputhje me interesat e përgjithshme ekonomike dhe sociale.

Vendimmarrja e përbashkët apo lënja e mundësisë që Qeveria tërësisht të marrë këtë rol rregullator për vete, mund të krijojë konflikte interesi dhe të cënojë autoritetin rregullator. Kjo ndikon negativisht në perceptimin e tregut për pavarësinë e Rregullatorit, duke rrezikuar besimin e investitorëve dhe efikasitetin e politikave energjetike. Në një kohë kur Kosova është në rrugëtimin e saj drejt dekarbonizimit dhe kërkon të tërheqë investime në burime të riëpërtrishme dhe shërbime energjetike, është jetike që klima e besimit dhe stabilitetit rregullator të jetë e pacenueshme.

Komenti 6. Neni 6 – Çmimet e furnizimit të bazuara në treg, Paragrafi 4

“Me qëllim të krijimit të konkurrencës efektive ndërmjet furnizuesve për kontratat e furnizimit me energji dhe për të arritur çmime plotësisht efektive me pakicë të energjisë dhe të bazuar në treg, **Ministria, pas marrjes së një mendimi paraprak nga Rregullatori, mund të vendosë përkohësisht të subvencionojë energjinë e furnizuar për konsumatorët familjar dhe mikrondërmarrjet të cilët nuk përfitojnë nga subvencioni sipas paragrafit 2 të këtij neni, me kusht që përveç kriterëve të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni, masa të tilla do të:**”

Një paragraf i tillë është i dëmshëm për tregun energjetik. INDEP avokon për një treg të hapur, me konkurrueshmërinë në qendër të tij. Ndër të tjera, një paragraf i tillë lë hapësirë për shfrytëzime e përfitime politike, me kauzë të subvencionimit energjetik.

Në kontekstin e liberalizimit të tregut energjetik dhe përpjekjeve për të siguruar konkurrencë të drejtë dhe efikase, mbështetja ndaj konsumatorëve të cënuar përmes subvencioneve qeveritare luan rol të rëndësishëm, nëse zbatohet me kujdes dhe në përputhje me kritere të qarta dhe objektive. Megjithatë, është esenciale që ndërhyrjet e tilla të bëhen nëpërmjet skemave të mirëqenies sociale dhe jo përmes vendimeve të drejtpërdrejta që ndërhyjnë në dinamikën e tregut të lirë, të cilat mund të pengojnë konkurrencën dhe të krijojnë pasoja të padëshiruara në tregun e energjisë.

Ne kërkojmë heqjen e kësaj dispozite në mënyrë që të theksohet rëndësia e ndërtimit të një tregu të hapur dhe konkurrues, ku çmimet e energjisë përcaktohen nga forcat e tregut dhe jo nga ndërhyrjet arbitrare qeveritare. Përkrahja për konsumatorët në nevojë duhet të jetë e bazuar në kritere të qarta dhe në objektiva, të integruara brenda skemave ekzistuese të mbrojtjes sociale, duke u siguruar kështu që ndihma arrin tek ata që kanë më së shumti nevojë pa cenuar konkurrencën në treg.

Ndërhyrja e drejtpërdrejtë nga ana e qeverisë, pa marrë parasysh intencat e mira për të mbështetur ndërmarrjet e caktuara apo konsumatorët familjar, krijon një precedent të rrezikshëm që nxitë keqpërdorimin politik, duke lënë hapësirë për interpretim dhe zbatim arbitrar. Kjo jo vetëm që minon konkurrencën e shëndetshme por gjithashtu pengon përpjekjet për një liberalizim të plotë të tregut të energjisë, një objektiv ky kyç për integrimin evropian dhe zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik të Kosovës.

Komenti 7. Neni 10 – Objektivat e Politikës së Energjisë

INDEP propozon që pika 1.1, e paragrafit **“1. Politika e energjisë së Republikës së Kosovës synon të sigurojë“**, të jetë: **“1.1. tranzicionin dhe dekarbonizimin”**. Është kruciale që një pikë e tillë të jetë pikë parësore dhe e integruar në këtë ligj, për faktin që është në linjë me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031, me direktivat Evropiane dhe me objektivat strategjike që vendi ynë tashmë ka vendosur.

Përfshirja e tranzicionit dhe dekarbonizimit si objektiva kyçe në pikën 1.1 të Politikës së Energjisë të Republikës së Kosovës reflekton jo vetëm angazhimin e vendit për të adresuar sfidat e ndryshimeve klimatike por gjithashtu për t'u harmonizuar me direktivat dhe qëllimet e politikës energjetike të Bashkimit Evropian. Ky propozim është në përputhje të plotë me Strategjinë e Energjisë së Republikës së Kosovës 2022-2031, e cila përcakton rrugën për një ekonomi më të gjelbër dhe më të qëndrueshme përmes përdorimit të energjisë së ripërtrishme dhe eficiencës së energjisë.

Bazimi në tranzicion dhe dekarbonizim si pjesë integrale e politikës energjetike të Kosovës është vendimtar për të siguruar një të ardhme energjetike të qëndrueshme që mbron mjedisin, nxit inovacionin dhe siguron siguri energjetike. Duke e bërë këtë objektiv si prioritet të politikave dhe duke e nënvizuar në legjislacion, Kosova përmbushë angazhimet ndaj direktivave ndërkombëtare dhe gjithashtu sublimon synimet për të ndërtuar një ekonomi më të fortë dhe më rezistente ndaj ndikimeve të ndryshimeve klimatike.

Prandaj, ky ndryshim në ligj është shumë i rëndësishëm për të reflektuar seriozitetin e angazhimit të Kosovës ndaj tranzicionit energjetik dhe dekarbonizimit, duke qenë në harmoni të plotë me qëllimet strategjike të vendit dhe duke siguruar një udhërrëfyes të qartë për të gjithë aktorët në sektorin e energjisë në Kosovë.

Komenti 8 . Neni 10 – Objektivat e Politikës së Energjisë

Tek Paragrafi 1.6. i këtij neni, që thekson si më poshtë:

“ofrim efikas të shërbimeve dhe mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të konsumatorëve fundor;”

Të shtohet edhe fuqizimi i konsumatorit. Pra, INDEP propozon që fjalia e lartëcekur të formulohet në këtë mënyrë:

“ofrim efikas të shërbimeve, mbrojtjen, **fuqizimin** dhe promovimin e të drejtave të konsumatorëve fundor;

Në tregun e ri të energjisë dhe sidomos me liberalizimin e tij dhe përfshirjen e më shumë ndërmarrjeve të furnizimit dhe prodhimit, përfshirja e konsumatorëve në tregun e energjisë është vitale për t'i pajisur ata me mjetet dhe informacionin e nevojshëm për të bërë zgjedhje të informuara dhe për të ushtruar në mënyrë efektive të drejtat e tyre. Për këtë, konsiderojmë që ky element duhet të përfshihet në nenin 10 të projektligjit.

Komenti 9. Neni 10 – Objektivat e Politikës së Energjisë

Të shtohet Paragrafi 1.16., për të cilën INDEP propozon këtë formulim:

“1.16. krijimin e vendeve të reja të punës në sektorin e energjisë“

Politikat e energjisë, përveç tranzicionit energjetik dhe përfitimeve mjedisore, kanë për qëllim edhe të stimulojnë ekonominë, të diversifikojnë burimet e energjisë dhe të krijojnë mundësi të reja për punësimin e qytetarëve, duke kontribuar kështu në një tranzicion energjetik të qëndrueshëm dhe një të ardhme më të prosperuar për Kosovën. Ne konsiderojmë që ky objektivi duhet të shtohet në Nenin 10.

Komenti 10. Të shtohet neni 10a – Objektivi Afatgjatë i Dekarbonizimit

Ne propozojmë që Ligji për Energjinë duhet të ketë të integruar e të shpjeguar cakun afatgjatë për dekarbonizim. Një objektivi i tillë tashmë është i përcaktuar edhe me Strategjinë e Energjisë së Kosovës 2022-2031. Andaj, integrimi i këtij neni është i domosdoshëm edhe për këtë ligj. Gjithashtu, ky nen duhet t'i japë bazë ligjore hartimit të Strategjisë Afatgjate të Dekarbonizimit dhe të vendosë ligjërisht obligimin e marrë të Kosovës në Samitin e Sofjes. INDEP propozon që neni 10 a të formulohet si më poshtë:

Neni 10a - Objektivi Afatgjatë i Dekarbonizimit

1. Me qëllim të harmonizimit me angazhimet e vendosura në Strategjinë e Energjisë së Kosovës 2022-2031 dhe përmbushjen e obligimeve ndërkombëtare të marrë nga Republika e Kosovës, përfshirë ato të Samitit të Sofjes, ky Ligj përcakton objektivin afatgjatë të dekarbonizimit të vendit drejt arritjes së emetimeve neto zero deri në vitin 2050.
2. Ky objektiv do të mbështetet nga zhvillimi dhe implementimi i Strategjisë Afatgjate të Dekarbonizimit, e cila do të përfshijë masat specifike, hapat e nevojshëm, dhe afatet kohore për reduktimin progresiv të emetimeve të gazrave serrë në të gjitha sektorët e ekonomisë, me synimin për arritjen e neutralitetit të karbonit deri në vitin 2050.
3. Ministria përgjegjëse për mjedis dhe klimë në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për energji do të hartojnë, përditësojnë dhe monitorojnë zbatimin e Strategjisë Afatgjate të Dekarbonizimit, në bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët relevante, përfshirë institucionet qeveritare, sektorin privat, shoqërinë civile dhe partnerët ndërkombëtarë.
4. Kjo Strategji do të përditësohet periodikisht për të pasqyruar zhvillimet teknologjike, ndryshimet në politikat ndërkombëtare mbi klimën dhe përparimin e arritur drejt objektivit afatgjatë të dekarbonizimit.

Dekarbonizimi është thelbësor për reduktimin e ndotjes së ajrit dhe emetimeve të gazeve serrë, duke kontribuar në përpjekjet globale për të kufizuar rritjen e temperaturës dhe për të zbutur ndikimet klimatike. Andaj, është kryciale që një nen i tillë të jetë pjesë e Ligjit për Enejninë.

Komenti 11. Të përcaktohen afatet kohore, perspektiva dhe rishikimi i Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës

INDEP propozon që në linjë të njejtë me Paragrafin 2 të Nenit 11 – Strategjia Kombëtare e Energjisë, i cili përcakton periudhën, perspektivën dhe rishikimin e Strategjisë, të shtohet Paragrafi 2 tek Neni 12 – Plani Kombëtar i Energjisë dhe Klimës i cili gjithashtu do të përcaktojë periudhën, perspektivën dhe rishikimin e PKEK-së. Njëherazit, INDEP propozon që të shtohet edhe Paragrafi i rradhës për Nenin 12, i cili vendos hartimin e Programit të Zbatimit të Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë.

Komenti 12. Neni 13 – Bilanci Vjetor Indikativ i Energjisë

Tek Paragrafet 6, 7, dhe 8 të këtij neni, duhet të **eliminohet** fjalia “**pas marrjes së mendimit nga Ministria**”. Bilanci Vjetor Indikativ i Energjisë është dokument i cili pregaditet nga akterët kyç, relevant e kryesor të sektorit të energjisë në Republikën e Kosovës. Pra, hartimi i këtij dokumenti bëhet nga Operatio i Sistemit të Transmetimit të Energjisë Elektrike, dhe publikohet nga Rregullatori. INDEP vlerëson se Ministria nuk duhet të japë mendime për këtë dokument, për

arsye se ndikon direkt në punën, ekspertizën dhe pavarësinë e këtyre dy akterëve të sektorit të energjisë.

Komenti 13. Neni 14 – Roli i organeve të vetëqeverisjes lokale

INDEP propozon që të shtohen Paragrafet, 2.4., 2.5. dhe 2.6., të cilat duhet të kenë këtë përmbajtje:

- 2.4. hartojnë Planet Komunale për Energji dhe Klimë,
- 2.5. hartojnë Raporte Vjetore të Performancës Energetike Komunale,
- 2.6. funksionalizojnë zyrat e menaxhimit të energjisë.

INDEP vlerëson se integrimi i këtyre paragrafëve është një hap kritik drejt decentralizimit të qeverisjes së energjisë dhe rritjes së kapaciteteve lokale për menaxhimin e qëndrueshëm të energjisë dhe veprimin për klimën.

Propozimi për shtimin e Paragrafëve 2.4, 2.5, dhe 2.6 në Nenin 14 të Ligjit për Energjinë, që përcakton rolin e organeve të vetëqeverisjes lokale në hartimin e Planeve Komunale për Energji dhe Klimë, hartimin e Raportëve Vjetore të Performancës Energetike Komunale dhe funksionalizimin e zyrave të menaxhimit të energjisë, e rritë rëndësinë e decentralizimit të tranzicionit të energjisë dhe forcimin e kapaciteteve lokale.

Këto ndryshime i mbështesin komunat për të marrë një rol më aktiv dhe të përgjegjshëm në menaxhimin e qëndrueshëm të burimeve energetike dhe në ndërmarrjen e veprimeve konkrete për luftimin e ndryshimeve klimatike. Përmes hartimit të planeve specifike dhe raportimeve të rregullta, komunat do të jenë në gjendje të vlerësojnë dhe të monitorojnë me efikasitet performancën e tyre energetike dhe të identifikojnë mundësitë për përmirësim. Ndërsa, funksionalizimi i zyrave të menaxhimit të energjisë do të sigurojë një qasje të koordinuar dhe të specializuar për adresimin e sfidave energetike dhe klimatike në nivel lokal. Këto veprime jo vetëm që do të rrisin transparencën dhe përgjegjësinë në menaxhimin e energjisë por gjithashtu do të nxisin pjesëmarrjen e komunitetit dhe do të kontribuojnë në arritjen e objektivave kombëtare dhe ndërkombëtare të qëndrueshmërisë dhe ndryshimeve klimatike të cilat pa një qasje të decentralizuar, nuk do të mund të arrihen!

Komenti 14. Neni 15 – Planet Zhvillimore të Operatorëve të Sistemit

Ne propozojmë që të shtohet Paragrafi 6.5., e cila duhet të ketë këtë përmbajtje:

- 6.5. hartat që shpjegojnë kapacitetet, punimet dhe investimet

Shtimi i Paragrafit 6.5 në Nenin 15 të Ligjit për Energjinë, i cili kërkon nga operatorët e sistemit të përgatisin harta që shpjegojnë kapacitetet, punimet dhe investimet, rrit ndjeshëm transparencën e

sektorit të energjisë. Kjo mundëson monitorimin më të detajuar të infrastrukturës energjetike dhe të planifikimit të investimeve, duke ofruar një pasqyrë të qartë të zhvillimeve aktuale dhe të planifikuara në rrjetin energjetik. Kjo jo vetëm që rrit kapacitetet monitoruese të institucioneve rregullatore dhe të interesuarve të tjerë, por gjithashtu forcon mbrojtjen e konsumatorëve duke siguruar që ata janë të informuar mbi zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve të energjisë. Transparenca e shtuar mbi kapacitetet, punimet dhe investimet ndihmon në krijimin e një tregu më konkurrues dhe të qëndrueshëm të energjisë, ku vendimet e informuara të investimeve dhe menaxhimi efikas i burimeve ndikon pozitivisht në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e furnizimit me energji për të gjithë konsumatorët.

Komenti 15. Neni 17 – Lloji i aktiviteteve të energjisë

INDEP propozon që të shtohet Paragrafi 1.9. menaxhimi i energjisë, si një nga aktivitetet e energjisë që janë në kuptim të ligjit në fjalë.

Shtimi i Paragrafit 1.9 në Nenin 17 të Ligjit për Energjinë, që përfshin menaxhimin e energjisë si një nga aktivitetet kyçe të energjisë të njohura me ligj, është një hap i rëndësishëm për të rritur rëndësinë e një qasjeje të integruar dhe të mençur ndaj përdorimit dhe furnizimit me energji. Me këtë njihet zyrtarisht menaxhimi i energjisë si një segment vital i ekosistemit energjetik, dhe promovohet përmirësimi i eficiencës energjetike në të gjitha nivelet. Duke e përfshirë menaxhimin e energjisë si një aktivitet ligjor, ligji inkurajon investimet në teknologjitë dhe metodologjitë e reja që ndihmojnë në monitorimin, kontrollin dhe optimizimin e konsumit të energjisë, duke kontribuar në reduktimin e kostove për konsumatorët dhe në uljen e ndikimit mjedisor të aktiviteteve njerëzore. Kjo qasje është në përputhje me angazhimet ndërkombëtare për qëndrueshmëri duke u bërë një element kyç në tranzicionin e vendit drejt një ekonomie me intensitet të ulët të karbonit.

Komenti 16. Neni 19 – Informacioni konfidencial, Paragrafi 3

Te Paragrafi 3 i Nenit 19 – Informacioni konfidencial, të largohet Ministria dhe të jetë vetëm Rregullatori ai që mund të kërkojë nga ndërmarrjet e energjisë që t'u ofrojnë informata konfidenciale. Pra, INDEP propozon që ky paragraf të ristrukturohet në këtë mënyrë:

“Pavarësisht nga paragrafi 1 i këtij neni, Rregullatori ~~dhe Ministria~~ gjatë ushtrimit të kompetencave, funksioneve dhe detyrave të tij ~~tyre~~ mund të kërkojë nga ndërmarrjet e energjisë që t'u ofrojnë informata konfidenciale. Me marrjen e informatave nga Rregullatori ~~ose Ministria~~, nëse konsiderohet se informatat e tilla janë të regjistruara dhe konfidenciale, ato mbrohen dhe nuk jenë objekt i ligjeve që rregullojnë qasjen në dokumente publike.”

Komenti 17. Neni 19 – Informacioni konfidencial, të shtohet Paragrafi 4

INDEP propozon që pjesë e këtij neni të jetë edhe Paragrafi 4, si më poshtë:

“Informacionet që nuk janë konfidenciale, të lejohen që të kenë qasje të gjitha palët e interesit, duke përfshirë edhe publikun.”

Kjo ndikon në rritjen e transparencës, në zvogëlimin e keqinterpretimeve, në zvogëlimin e keqpërdorimeve dhe benefiteve të tjera. Gjithashtu, qasja në informacionet që nuk janë konfidenciale kontribuon në informimin e drejtë të publikut, gjë që shpesh herë si pasojë e mos lejimit të qasjes në këto informacione, krijon lajme të rrejshme dhe keqinterpretime të ndryshme.

Propozimi i INDEP përforcon pavarësinë dhe autoritetin e Rregullatorit në marrjen dhe menaxhimin e informacioneve konfidenciale nga ndërmarrjet e energjisë. Duke Ministrinë dhe duke e fokusuar këtë detyrim ekskluzivisht te Rregullatori, ne sigurojmë një qasje më të drejtpërdrejtë dhe të qartë në trajtimin e të dhënave konfidenciale. Kështu rritet jo vetëm efikasiteti dhe përgjegjësia në mbledhjen dhe analizimin e informacioneve të ndjeshme, por gjithashtu garantohet një nivel më i lartë i mbrojtjes së të dhënave, duke minimizuar mundësinë e keqpërdorimit të informacioneve të ndjeshme. Rregullatori, me kompetencat e tij të veçanta, është në pozitën më të mirë për të vlerësuar dhe trajtuar këto informacione me përgjegjësi të plotë, duke u siguruar që ato të përdoren në mënyrë të përshtatshme për monitorimin dhe rregullimin e sektorit të energjisë, duke mbrojtur në të njëjtën kohë të drejtat e subjekteve që zotërojnë këto informacione.

Komenti 18. Neni 19 – Informacioni konfidencial

INDEP kërkon që të përcaktohen se cilat janë informatat konfidenciale. Të integrohet një listë e detajuar e informacioneve të cilat klasifikohen si konfidenciale.

Përcaktimi i qartë dhe i detajuar i informacioneve që klasifikohen si konfidenciale në Nenin 19 të Ligjit është jetik jo vetëm për të mbrojtur tregun dhe pjesëmarrësit për një ambient të hapur dhe konkurrues, por gjithashtu për të siguruar që të dhënat e disponueshme janë të dobishme për hulumtim dhe për një qasje transparence.

Shtimi i kësaj liste do të mundësojë një ekuilibër mes nevojës për mbrojtjen e informacionit me ndjeshmëri të lartë tregtare dhe interesi publik për qasje në informacion që nxit inovacionin, zhvillimin e politikave të bazuar në të dhëna dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë energjetike. Duke integruar një listë të detajuar të informacioneve që konsiderohen konfidenciale, dhe potencialisht duke e përcaktuar edhe limitin kohor kur trajtohen të tilla, ligji do të ofrojë orientime të qarta për ndërmarrjet e energjisë mbi atë që duhet të mbrohet, ndërsa njëkohësisht do të mbrojë hapësirën për qasjen në të dhëna që mund të përdoren për qëllime të kërkimit dhe për të nxitur hapjen. Kjo parandalon përdorimin e gabuar të etiketës së konfidencialitetit për të fshehur informacione që janë të rëndësishme për transparencën publike dhe për avancimin e njohurive në fushën e energjisë.

Komenti 19. Neni 22 - Sistemet e mbyllura të Shpërndarjes, Paragrafi 1

INDEP kërkon riformulimin e paragrafit 1. Në formën aktuale është i paqartë:

“...i cili operon brenda një zone gjeografikisht të kufizuar, i shërben dy ose më shumë shfrytëzuesve dhe nuk parashikon furnizimi me energji elektrike, gaz ose energji termike për konsumatorët familjarë, me përjashtim të rasteve të shfrytëzimit të rastësishëm nga një numër i vogël familjesh me punësim ose shoqata të ngjashme me pronarin e sistemit të shpërndarjes dhe që ndodhen brenda zonës së shërbyer nga sistemi i shpërndarjes...”

Kjo pjesë e ligjit lë hapësirë për interpretime të paqarta rreth asaj se çfarë përbën "shfrytëzim të rastësishëm" dhe si definohet "një numër i vogël familjesh". Për të siguruar që kjo pjesë e ligjit të mos keqpërdoret dhe të mbrojtë interesat e konsumatorëve familjarë, është thelbësore të shtohet një përkufizim më i qartë dhe i detajuar mbi këto kritere. Pa një sqarim të mjaftueshëm, ekziston rreziku që operatorët apo institucionet të interpretojnë këtë pjesë në mënyrë që të limitojnë qasjen në shërbime të rëndësishme energjetike për konsumatorët familjarë në situata ku furnizimi mund të jetë esencial për mirëqenien e tyre. Rekomandojmë ose riformulimin ose definimin e këtyre koncepteve në ligj që do të ndihmonte në sqarimin e kësaj pjesë dhe do të siguronte një zbatim më të drejtë dhe transparent të ligjit.

Komenti 20. Neni 22 – Sistemet e mbyllura të Shpërndarjes, Paragrafi 10

INDEP kërkon që pjesë e paragrafit 10 të jetë edhe një afat i cili krijon kornizën kohore për Rregullatorin dhe për miratimin e rregullave për funksionimin e një sistemi të mbyllur të shpërndarjes. Përcaktimi i afatit kohor do të eliminonte mundësitë për keqinterpretime.

Komenti 21. Neni 25 - Kompetencat e autoriteteve rregullative për çështjet e konkurrencës

INDEP konsideron që Paragrafi 4 i Nenit 25 të Projektligjit për Energjinë është i panevojshëm dhe rrjedhimisht kërkon largimin e tërësishëm të këtij paragrafi. Bashkëpunimi në mes të autoriteteve dhe institucioneve qëndrore të Republikës së Kosovës është obligativ që nga Kushtetuta tek neni 13 i Ligjit Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë dhe neni 64 të Ligjit Nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës.

Përfundime dhe Rekomandime

Procesi i konsultimit për legjislacionin në fushën e energjisë paraqet një mundësi kyçe për të inkorporuar perspektiva dhe ekspertizë të ndryshme për të përmirësuar dhe forcuar kornizën ligjore që rregullon sektorin energjetik të Kosovës. Është evidente se përfshirja e komenteve dhe vërejtjeve nga Zyra e Rregullatorit dhe institucionet e tjera relevante në Dokumentin e Konsultimit rrit transparencën, duke siguruar një qasje më gjithëpërfshirëse dhe praktike. Prandaj rekomandojmë që Dokumenti i Konsultimit të listojë në mënyrë eksplicite të gjitha komentet dhe sugjerimet e dorëzuara nga Zyra e Rregullatorit dhe institucionet tjera të përfshira në konsultimet e grupit punues. Kjo qasje do të rrisë transparencën, do të lehtësojë vendimmarrjen e informuar dhe do të sigurojë që të gjitha njohuritë përkatëse të merren parasysh nga palët që duan të komentojnë në procesin e konsultimit publik.

Qartësia dhe specifika e dispozitave ligjore janë thelbësore për hartimin dhe zbatimin efektiv të legjislacionit për energjinë. Paqartësitë në draftin aktual mund krijojnë sfida në interpretim dhe zbatim, duke penguar potencialisht arritjen e qëllimeve të sektorit të energjisë. Ne rekomandojmë që të bëhet një rishikim i detajuar i tekstit legjislativ dhe të adresohen komentet tona, veçanërisht ato që lidhen me përcaktimin e informacionit konfidencial, rolin e organeve të vetëqeverisjes lokale dhe klasifikimin e aktiviteteve energjetike. Përkufizimet dhe dispozitat më të qarta ligjore do të lehtësojnë përputhshmërinë, do të rrisin mbikëqyrjen rregullatore dhe do të mbështesin funksionimin efektiv të tregut të energjisë.

Avancimi i sektorit energjetik të Kosovës drejt qëndrueshmërisë dhe efikasitetit varet nga adoptimi i praktikave rregullatore largpamëse dhe inovative. Ndryshimet e propozuara, duke përfshirë objektivin afatgjatë të dekarbonizimit dhe theksin në menaxhimin e energjisë si një aktivitet i njohur, pasqyrojnë një orientim strategjik drejt qëndrueshmërisë mjedisore dhe ekonomike. Qeveria të pranojë këto rekomandime dhe propozime për ndryshim të draftit për të harmonizuar politikat energjetike të Kosovës me standardet dhe zotimet ndërkombëtare. Më tej, nxitja e një mjedisi të favorshëm për investime në burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe teknologjitë me eficiencë energjetike është thelbësore për tranzicionin e Kosovës drejt një të ardhmeje të qëndrueshme energjetike.

INDEP do të vazhdojë të jetë akter konstruktiv dhe aktiv në sektorin e energjisë në vend, jo vetëm në zbatim të programit për zhvillim të qëndrueshëm, por për të kontribuar drejtpërdrejtë në përshpejtimin e tranzicionit energjetik dhe përqaftimit të së ardhmes së gjelbër, e cila është e rrënjësor në misionin e institutit tonë.

Ky punim u botua me mbështetjen e Fondit të vëllezërve Rockefeller. Përmbajtja e këtij dokumenti përfshirë opinionet e shprehura, nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të donatorëve të INDEP-it, stafit të tyre, bashkëpunëtorëve apo bordit.

Mbështetur nga:



Zbatuar nga:

